

AKT THEMELIMI
&
STATUT I SHOQËRISË TREGTARE TË SË DREJTËS SHQIPTARE
EXPLORE ALBANIA HOLIDAYS "SH.P.K"

KREU I
THEMELIMI, EMRI, AKTIVITETI, KOHËZGJATJA, SELIA.

NENI 1
Data e themelimit, Emri, Emërtimi tregtar dhe Ortaku Themelues

Sot, më datë: **24/04/2025**, Ortaku i Vetëm Themelues, krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin EXPLORE ALBANIA HOLIDAYS.

Emërtimi tregtar i shoqërisë është EXPLORE ALBANIA HOLIDAYS

Ortaku i vetëm Themelues i Shoqërisë është: Shoqëria anonime greke EGH GROUP S.A, e themeluar sipas ligjeve greke, e regjistruar në Regjistrin e Përgjithshme Tregtar të Republikës së Greqisë me numër regjistrimi 161160001000, me seli në adresën: Rr. Sygrouy 214, në Bashkinë e Kalitheas në Atikë të Greqisë.

NENI 2
Qëllimi - Aktiviteti tregtar

Shoqëria do të ushtrojë aktivitet tregtar si më poshtë: Zyrë e ofrimit të shërbimeve të turizmit.

NENI 3
Kohëzgjatja

Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar kohor.

NENI 4
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë-Shqipëri, në adresën: Rr. Kavajës, Nr.4, Kati 6, Ap. 32, Kod Postar 1001, Tiranë.

KREU II
KAPITALI THEMELTAR - KUOTA

NENI 5
Kapitali themeltar dhe kuota

Kapitali themeltar i shoqërisë EXPLORE ALBANIA HOLIDAYS **SH.P.K** është 100,000 euro **(njëqind mijë euro)**, konvertuar në lek në vlerën 9,873,000 lekë (nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë lekë) sipas kursit të Bankës së Shqipërisë të datës 24/4/2025 si 98.73 lek/1 euro) dhe ndahet në 1 (një) kuotë.

Vlera nominale e 1 (një) kuote është 9,873,000 lekë (nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë lekë)

Pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë: Shoqëria anonime greke EGH GROUP S.A, e themeluar sipas ligjeve greke, e regjistruar në Regjistrin e Përgjithshme Tregtar të Republikës së Greqisë me numër regjistrimi 161160001000, me seli në adresën: Rr. Sygrouy 214, në Bashkinë e Kalitheas në Atikë të Greqisë, që **zotëron** kuotën e vetme të kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale prej 9,873,000 lekë (nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë lekë), e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme/Vendim të Ortakut të Vetëm e cila mbledhet për këtë qëllim dhe vendos sipas parashikimeve të nenit 10 të këtij statuti.

NENI 7

Tjetërsimi i kuotave

Kuota e kapitalit të shoqërisë mund të tjetërsohet nëpërmjet:

- a) shitblerjes;
- b) dhurimit;
- c) trashëgimisë,
- d) me çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8

Asambleja e Përgjithshme

Të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme i takojnë dhe ushtrohen nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë dhe miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- i. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ii. investimet të çdo lloji dhe vlerë monetare;
- iii. ndryshimet e statutit;
- iv. emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- v. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- vi. përcaktimin e shpërblimit të administratorit si dhe të likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- vii. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- viii. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ix. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- x. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- xi. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- xii. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- xiii. dhënien e kredive të tretë,
- xiv. shpërndarjen e fitimeve vjetore,
- xv. për të gjitha veprimet e tjera për të cilat mund të jetë vendosur kufizim kompetene ndaj administratorit të shoqërisë.

Ortaku i Vetëm është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkeljet e Statutit dhe ligjit.

NENI 9

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga ortaku i vetëm dhe/ose nga administratori i shoqërisë dhe mbledhet, si rregull, në selinë e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme thirret me shkresë ose nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit (e-mail) dhe thirrja duhet të përmbajë përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes si dhe rendin e ditës.

Asambleja e përgjithshme mund të mbledhet gjithashtu dhe në çdo vend tjetër, si brenda ashtu dhe jashtë territorit të Shqipërisë dhe të aksesueshëm lehtë nga pjesëmarrësit, si dhe në selinë/adresën e Ortakut të Vetëm.

Kur Asambleja e përgjithshme mbledhet pa ndjekur procedurën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, mund të marrë vendime të vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë dhe ata pranojnë të marrin vendime pavarësisht nga parregullsia.

Administratori i shoqërisë nuk mund të përfaqësojë me autorizim Ortakun e Vetëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 10

Kompetenca në vendimmarrje

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë e përbërë nga Ortaku i Vetëm, është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Procedura në marrjen e vendimeve, mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve etj., i përshtatet natyrës së organizimit të shoqërisë si "SHPK me Ortak të Vetëm". Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë merren me vetëm miratimin e këtyre të fundit nga Ortakut i Vetëm.

NENI 11

Administratori - Mandati i tij

Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë.

Mandati i administratorit: Mandati i administratorit është 5 vjet dhe fillon nga data e themelimit të shoqërisë në 24.04.2025 dhe deri në datën **31.12.2028**. Mandati i administratorit të shoqërisë mund të rinovohet për një afat tjetër me vendim të Asamblesë së Përgjithshme/Ortakut të Vetëm.

Administratori i parë i shoqërisë do të jetë: Shtetasi grek, Diogenis Venetopoulos i biri i Triantafylos dhe i Loukias, i datëlindjes 09/02/1979, me vendlindje në Holargo të Atikës në Greqi, banues në Voula të Atikës, në Rr. Amfikleias nr. 17, mbajtës i pasaportës biometrike të lëshuar nga

autoritetet greke me Nr. AT3032672, me datë lëshimi 23/09/2021 dhe datë skadence 22/09/2026, mbajtës i kartës së identitetit greke me nr. A00025984 lëshuar në datë 10.10.2023, me nr. Identifikimi tatimor në Greqi 070935843.

NENI 12

Humbja e mandatit të Administratorit - Dorëheqja

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, ushtrohen sipas dispozitave ligjore të ligjit 9901/14.04.2008 «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare» të ndryshuar dhe të K. Proçedurës Civile.

Administratori humbet mandatin e tij me dorëheqje. Administratori mund të japë dorëheqjen nga detyrat e tij, për shkaqe të arsyeshme, duke bërë njoftim paraprak, në një kohë të përshtatshme, për të mundësuar vazhdimësinë normale të veprimtarisë së shoqërisë dhe vazhdimin e veprimeve nga Ortaku i Vetëm dhe/ose nga administratori i ri i caktuar. Për këtë arsye, administratori thërret Asamblesën e Përgjithshme dhe dorëzon kërkesën e tij për dorëheqje. Dorëheqja prodhon efekte pas pranimit të saj me vendim të Asamblesë.

NENI 13

Kompetencat e Administratorit

Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë dhe në tagrat e tij përmbahen veçanërisht dhe në mënyrë eksplícite veprimet e poshtëcituar:


- i. Përfaqësimi i shoqërisë kundrejt palëve të treta,
- ii. menaxhimin e punëve të përditshme të shoqërisë, duke zbatuar politikat e vendosura dhe të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme,
- iii. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të inventarit, dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
- iv. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë për miratim;
- v. raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- vi. zbaton vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë.
- vii. Çdo veprim apo akt tjetër, brenda kompetencave të tij të parashikuara në ligjin 9901/dt.14.04.2008.

NENI 14

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, gjatë mandatit të tij të administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të administratorit dhe të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme dhe që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.



Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- i. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- ii. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- iii. të vlerësojë më përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- iv. të parandalojë dhe të mënjanojë rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- v. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhen në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

KREU IV

Viti Financiar – Bilanci – Fitimet – Likuidimi – Prishja e shoqërisë

NENI 15

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon në 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

NENI 16

Bilanci vjetor

Bilanci vjetor duhet të paraqitet te organet tatimore pasi të miratohet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, brenda datës 31 Mars të çdo viti pasardhës.

NENI 17

Fitimet

Fitimet që realizon shoqëria, i shpërndahen Ortakut të Vetëm, me vendim të tij.

NENI 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo moment, me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë. Për këtë arsye emërohet nga Ortaku i vetëm i shoqërisë, një likuidator me tagra të përcaktuara në ligj. Likuidatori është përgjegjës si ndaj shoqërisë ashtu dhe ndaj të tretëve. Ai shpërblehet në bazë të vendimit të Ortakut të vetëm të shoqërisë.

NENI 19

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Përsa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, Kodit Civil dhe çdo ligji të veçantë të Republikës së Shqipërisë.

NENI 20
Mosmarrëveshjet

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente Gjykatat Shqiptare.

NENI 21
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit në (QKB) Qendrën Kombëtare të Bisnesit.

(Firma – Vula)

Themelues & Ortaku i Vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“_shoqëria greke EGH GROUP S.A”

PËRFAQËSUAR NË NËNSHKRIMIN E KËTIJ AKTI THEMELIMI & STATUTI
nëpërmjet Prokurës së noterit grek numër 23.276 datë 11 Prill 2025

AV. MARSEL ZHUPA

